



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:168114

Datë: 13.09.2024

Numri i dokumentit: 06164698

KF.nr.433/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtaren Vera Gashi Bala, dhe zyrtaren ligjore Arta Hyseni, në kontestin tregtar - administrativ të paditësit “Matkos Pharm” Sh.P.K, me numër unik identifikues 811159624, dhe me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Sylejman Klinaku, Avokat nga Shoqëria e Avokatëve “Studio Ligjore & Financiare” në Prishtinë, kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, lidhur me padinë e paditësit për anulimin e vendimit, objekti i kontestit ndëshkim administrativ, vlerë e kontestit 1,000.00 euro, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor- publik, të mbajtur në prani të përfaqësuesit të autorizuar të palës paditëse Sylejman Klinaku Avokat, drejtorit të paditësit L.B. personalisht, dhe në mungesë të përfaqësuesit të palës së paditur me datë 05.09.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET kërkesëpadia e paditësit “Matkos Pharm” Sh.P.K, me numër unik identifikues 811159624 dhe seli në Prishtinë, si e bazuar.
- II. ANULOHET vendimi nr.205/2021 i datës 15.07.2021, i Departamentit të Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës dhe lënda kthehet në RISHQYRTIM DHE RIVENDOSJE tek e paditura.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi me padinë e paraqitur në Gjykatë, me datë 29.07.2021, ka iniciuar kontestin tregtar-administrativ kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, me kërkesë që të

aprovohet në tërësi si e bazuar padia dhe të anulohet vendimi nr.205/2021 datës 15.07.2021. Në seancën e shqyrtimit kryesor publik përfaqësuesi i palës paditëse ka deklaruar se mbesin në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, e kundërshtojmë fuqishëm përgjigjen në padi, sepse e njëjta nuk është profesionale duke u bazuar se kanë deklaruar gjëra të pa vërteta duke pretenduar se kanë qenë në vizitë tek selia e paditësit dhe me asnjë provë nuk e kanë dëshmuar vizitën e tyre në selinë e paditësit me të cilën edhe gjykata do të vërtetonte faktet vendimtare. Më tej ka shtuar se se paditësi shitjet që i bënë në tërë Kosovën i bënë tek tërë personat juridik dhe agjentët e saj nuk kanë arka fiskale me vete, por të gjitha shitjet regjistrohen në sistemin elektronik e i cili sistem është i lidhur edhe me ATK-në, si dhe paditësi më vonë e lëshon faturën për blerjet që ka bërë nga secili blerës nga agjentët e saj. Këtë fakt e vërteton edhe fatura e dorëzuar në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe të paditurën për çka e kundërshton pretendimin e të paditurës se paditësi nuk ka lëshuar faturë me rastin e shitjes në vlerë prej 60 euro për subjektin Mikrodent. Kontaktimin e të paditurës siç e ka cekur në vendimin me të cilin e ka gjobitur paditësin e paditura fare nuk e ka arsytuar me çfarë mënyre ka kontaktuar me personin në fjalë. Precizojmë kërkesëpadinë ashtu që kërkojmë anulimin e vendimit të të paditurës si dhe kthimin e mjeteve të paguara në emër të gjobës në shumë prej 1,000.00 euro dhe atë me kamatë ligjore në shkallë prej 8% nga data e paraqitjes së padisë. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka theksuar se pas administrimit të provave konsiderojmë se janë vërtetuar fakte vendimtare në atë mënyrë që e paditura ka gjobitur padrejtësisht paditësin, pa bazë ligjore prandaj kërkojmë nga gjykata që të aprovojë padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit “Matkos Pharm” Sh.P.K., të anulohet vendimi nr.205/2021 i datës 15.07.2021 dhe të detyrojë të paditurën që ti rimburojë paditësit shumën prej 1,000.00 euro të paguar nga paditësi në emër të gjobës dhe atë me kamatë ligjore në shkallë prej 8% nga dita e pagesës së gjobës deri në pagesën definitive, si dhe të paguajë shumën prej 51 euro në emër të taksës gjyqësore.

E paditura në përgjigje në padi të datës 26.06.2024, i ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e paraqitur në padi, si të pa bazuara në ligj dhe fakte materiale, dhe ka vlerësuar se vendimi i ATK-së nr.205/2021 i datës 15.07.2021, ka mbështetje ligjore, faktike dhe është në harmoni të plot me legjislacionin tatimor të aplikueshëm në Republikën e Kosovës. Tutje ka shtuar se ATK-ja, në bazë të shkresave në dosje si dhe bazuar në legjislacionin tatimor vendosi që tatimpaguesi të mbetet obligues i dokumentit të vendosjes së ndëshkimit në përputhshmëri me nenin 53.6 të Ligjit nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedura.

Gjykata ka shqyrtuar këtë kontest tregtar - administrativ konform dispozitave të nenit 41 të LKA-së, në mungesë të palës së paditur, ngase e paditura e ka pranuar ftesën për këtë seancë, ndërsa me parashtesën e datës 05.09.2024 e ka njoftuar gjykatën se nuk do të prezantoj në këtë seancë duke kërkuar nga gjykata që të veproj në pajtim me nenin 38 paragrafi 5 të LKA-së. Gjithashtu Gjykatës i ka propozuar që ta lë në fuqi Vendimin e Departamentit të Ankesave të ATK-së nr.205/2021 të datës 15.07.2021.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurë të provave të shqyrtimit gjyqësor kryesor - publik të datës 05.09.2024, ka administruar provat si në vijim: Përgjigje në padi e datës 26.06.2024, Vendim i ZGJONA nr.0293/2021 i datës 23.04.2021, Formë për vizitat përmbushëse e datës 18.03.2021, Vendimin nr.205/2021 i datës 15.07.2021, Faturë me nr. 21-F-99-01-04-217 e datës 19.03.2021 dhe Ankesë e paditësit e datës 28.05.2021.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thënieve në padi, përgjigjes në padi, shkresave të lëndës në këtë kontest tregtar administrativ, bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave se bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë konflikt administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë kontest tregtar administrativ, deklarimeve në padi dhe përgjigjes në padi, shkresat e lëndës, vendimi kontestues, dhe deklarimit në seancën e shqyrtimit gjyqësor, Gjykata ka gjetur se nuk është kontestuese fakti se Zyra për Gjopa dhe Ndëshkime me datë 23.04.2021 ka marr vendim nr.0293/2021 mbi shqiptimin e ndëshkimit administrativ në vlerë prej 1,000.00 €, për subjektin tatimpaguesin këtu paditësin, për shkak të mos lëshimit të kuponëve fiskal në vlerë prej 1x1,000.00 €. Jo kontestuese është edhe fakti se tatimpaguesi këtu paditësi ka parashtruar ankesë nr.205/2021 me datë 11.06.2021 në Divizionin e Ankesave, kundër vendimit nr.0293/2021 të datës 23.04.2021 nga Zyra për Gjopa dhe Ndëshkime Administrative. Po ashtu jo kontestuese mbetet edhe fakti se Administrata Tatimore e Kosovës-Divizioni i Ankesave me datë 15.07.2021 ka marrë vendimin nr.205/2021, si akt administrativ përfundimtar i nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë, me të cilin ka refuzuar ankesën e subjektit tatimor, e kundër të cilit paditësi me padinë e datës 29.07.2021, ka iniciuar kontestin tregtar - administrativ pranë gjykatës.

Nga administrimi i provave, përkatësisht forma e vizitës së përmbushjes së datës 18.03.2021, konstatohet se inspektori gjatë vizitës tek një subjekt tjetër tatimor “Mikro Dent” ka hasur se paditësi “Matkos Pharm” Sh.P.K., ka sjellë material në vlerë prej 60.00 € për subjektin “Mikro Dent”, me ç’rast është konstatuar se këtu paditësi nuk ka ofruar kuponë e as faturë. Tutje nga vendimi i Zyrës për Gjykatë dhe Ndëshkime administrative nr.0293/2021 rezulton se me datë 13.04.2021, është kontaktuar me përfaqësuesin e biznesit z. B.A. të cilit i është dhënë raporti AU 005, dhe deri me ditën e nxjerrjes së vendimit, përkatësisht deri me datë 23.04.2021 i njëjti nuk ka sjellë përgjigje. Andaj, e paditura ka vendosur që këtu paditësit ti shqiptoj ndëshkim për shkak të mos lëshimit të kuponëve fiskal, duke ju referuar dispozitave ligjore të nenit 53.6 të Ligjit 03/L-222 dhe nenit 43 paragrafi 103.2 të UA 15/2010.

Për gjykatën konstatimi se për blerjen e ndodhur është dashur të lëshohet kupon fiskal nuk qëndron, kjo për faktin se vet e paditura konstaton se subjekti tek i cili kanë qenë në vizitë është Mikro Dent e që nuk paraqet person fizik, por juridik dhe se vetëm mos lëshimi i kuponit fiskal nuk do të thotë se i njëjti nuk lëshon faturë. Andaj, gjykata vlerëson se baza ligjore në të cilën mbështetet vendimi është e pamjaftueshme, respektivisht kontradiktore me gjendjen faktike.

Tutje, për gjykatën mbetet e paqartë po ashtu lartësia e ndëshkimit administrativ, respektivisht gjykatë e shqiptuar, për të cilën e paditura as në vendimin me të cilin e ka ndëshkuar paditësin e as në vendimin përfundimtar nuk e ka arsyetuar se si ka llogaritur ndëshkimin në vlerë prej 1,000.00 euro. Cila dispozitë e nenit 53 të Ligjit Nr. 03/L-222 është aplikuar në rastin konkret.

Gjykata kërkon nga e paditura të sqarohet po ashtu lidhur me përfaqësuesin e cekur në vendim se si ka ardh deri tek informatat se personi në fjalë B.A., është përfaqësues i biznesit kur vet në dispozitiv të vendimit thekson se subjekti tatimor ...“me pronar/menaxher K.V.”.

Rrjedhimisht, vendimi i kontestuar nuk përmban një vlerësim të fakteve në raport me dispozitat ligjore, andaj një vendim i tillë nuk mund të quhet se është i drejtë dhe i ligjshëm dhe se është marr me respektimin e dispozitave ligjore të Ligjit për Procedurën Administrative.

Duke u referuar në dispozitat e nenit 43 të LKA-së, ku parashihet se gjykata vendos për çështjen e konfliktit administrativ, në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurën administrative,

gjatë administrimit të provave materiale në seancën e shqyrtimit kryesor gjykata nuk posedon argumente në të cilat është bazuar organi i paditur kur thekson se paditësi ka shitur mall pa kupon fiskal.

Gjykata vlerëson, se arsyetimi i vendimit nuk përmban arsye mbi faktet vendimtare, të vlefshme për zgjidhjen e drejtë të çështjes në shqyrtim dhe nuk përmban të dhëna lidhur me gjendjen faktike të vërtetuar nga ana e organit të paditur dhe provat me të cilat është vërtetuar gjendja faktike nuk janë vërtetuar, si dhe nuk përmban arsye lidhur me thëniet në ankesën e paditësit. Në këtë drejtim gjykata konsideron se pa dëshmi të mjaftueshme, provuese për çështjet kontestuese dhe pa e mbështet vendimin kontestues në prova të cilat e vërtetojnë qartë gjendjen faktike e paditura nuk ka mundur të nxjerr konkluzion të drejtë në këtë çështje administrative. Kjo për faktin se pretendimet duhet të argumentohen me prova dhe fakte të cilat organi i paditur është dashur ti konstatoj në vendin e ngjarjes në momentin ku ka ndodhe rasti. Andaj duke marre parasysh konstatimet e lartcekura Gjykata nuk mund të pajtohet me një qëndrim të tillë juridik të paditurës të dhënë në vendimin kontestues, për shkak se aktvendimi kontestues përmban të meta të cilat e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, të metat e tilla konsistojnë në faktin se arsyetimi i vendimit kontestuese përmban të dhëna të pamjaftueshme dhe jo të plota sa i përket vërtetimit të gjendjes faktike dhe si pasojë e kësaj edhe aplikimit të drejtës materiale për mos lëshimi të kuponëve fiskal të paditësit.

Gjykata konstaton se vendimi kontestues, nuk përmban informata të mjaftueshme me të cilën pala e paditur do të mund të kundërshtonte pretendimet e ankesës në vendimin kontestues. Gjykata vlerëson se e paditura nuk i është përgjigjur bazës së ankesës së paditësit, duke trajtuar çështjen jashtë objektit të kontestit, në këtë kuptim e paditura ka mbështet vendimin vetëm në bazë të konstatimeve të inspektorit tatimor, mirëpo këto konstatime nuk janë argumentuar edhe me asnjë provë të vetme me të cilën do të vërtetohet gjendja faktike, andaj në mungesë të fakteve për argumentimin e drejtë të gjendjes faktike nga e paditura, gjykata nuk mund të pajtohet me vërtetimin e një gjendje të tillë faktike pa prova dhe dëshmi përcjellëse të cilat do të mbështetshin një konstatim të tillë. Të metat e lartcekura janë të tilla që e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, prandaj gjykata në rivendosje e obligon të paditurën që të deklarohet lidhur me çështjet e theksuara më lart. Bazuar në nenin 81.F par.2 të ligjit Nr.04/L-102 të Udhëzimit Administrativ për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat Nr.03/L-222, “*Administrata tatimore, doganore ose ndonjë administratë tjetër*

*kompetente do të bart detyrimin e vërtetimit të fakteve të cilat e mbështesin vendimin dhe kundërshtojnë kërkesën e tatimpaguesit”.*

Gjykata kërkon nga e paditura Departamenti i Ankesave i ATK-së që në riprocedurë konform autorizimeve nga dispozitat e nenit 44 pika 44 dhe 45 të Udhëzimit Administrativ nr.15/2010 të marr dëshmi të reja nga inspektori tatimor, paditësi, palët e treta, rreth fakteve eventuale që nuk janë trajtuar në procedurën administrative të ankesave, dhe në fund të nxjerr konkluzion të drejt në kuptim të gjendjes faktike.

Obligohet e paditura Departamenti i Ankesave i ATK-së, që varësisht prej gjendjes faktike që do ta vërtetoj në procedurën e rishqyrtimit, të vendoset për të gjitha çështjet e ngritura gjatë zhvillimit të procedimit, dhe të marr vendim të drejtë dhe të bazuar në dispozitat e legjislacionit tatimor.

Gjykata vendos për çështjen e konfliktit administrativ në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurë administrative, në përputhje me nenin 43, paragrafi 1, të LKA-së. Në bazë të këtij parimi, gjykata e ka të pamundur të vendosë në mënyrë meritore në këtë konflikt administrativ për arsye se ekzistojnë të meta që e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar. Andaj gjykata aprovon padinë e paditësit, anulon aktvendimin e kontestuar dhe lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.

Sipas nenit 43, paragrafi 2, të LKA-së, përcaktohet se: *“Nëse gjykata konstaton se konflikti administrativ nuk mund të shqyrtohet në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurën administrative për shkak se në pikëpamje të fakteve të vërtetuara ekzistojnë kontradikta në akte, gjë që në pikat esenciale nuk janë vërtetuar plotësisht, ose konstaton se në procedurën administrative nuk janë respektuar rregullat e procedurës, që do të kishin rëndësi për zgjidhjen e çështjes, gjykata do të anulojë me aktgjykim aktin e kontestuar administrativ. Në një rast të tillë, organi kompetent ka për detyrë të veprojë ashtu si është caktuar në aktgjykim dhe të nxjerrë akt të ri administrativ”.* Andaj, gjykata bazuar në autorizimet nga neni 43, paragrafi 2, të LKA-së e detyron të paditurën që në ri-procedurë të veprojë sipas vërejtjeve të dhëna në arsyetimin e këtij aktgjykimi.

Vërejtjet e cekura janë të obligueshme për organin e paditur, duke u bazuar edhe në nenin 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Vendimin për shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 64 të LKA-së nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative.

Nga sa u tha më lart, gjykata, konform nenit 43, paragrafi 2, dhe nenit 46, paragrafët 1, 2 dhe 3, të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**  
Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal

KF.nr.433/22, datë 05.09.2024

Gjyqtarja  
Vera Gashi Bala

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.